

Regj.nr.10200/12

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN,Departamenti I pergjithshem-Divizioni I kundervajtjes,sipas Gjykatesit Veli Kryeziu,kunder te pandehurit **Sadudin Berisha nga Gjilani,Rruga Hamdi Berisha nr.21**,per shkak te kundervajtjes nga neni 17 p.1.3,te Ligjit nr.04/L-50 te Ligjit per deklarim,Prejardhjen dhe kontrollin e pasurise te zyrtarve te lart public,e ne baze te nenit 73,74,195 dhe 9 te Ligjit mbi kundervajtjet,me date 23.12.2013 muar kete :

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENSIA KUNDER KORUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dok.:	Nr. Prot.:
Dep.:	Pr. Prot.:
Dok.:	Prot. No. 03-4549/13
Nr. lag.:	Data:
Broj stranica:	Datum: 31-12-2013
Nr. pages:	
02	
PRISHTINE	

AKTVENDIM

E pandehura **Sadudin Berisha nga Gjilani,Rruga Hamdi Berisha nr.21** nga ~~l~~ ~~ati~~ ~~isa~~ i lindur me 29.06.1954 neGjilan, tani me vendbanim ne Gjilan,shqiptar ,shtetas i Republikes se Kosoves,me profesion Jurist I diplomuar,i gjendjes se mesme ekonomike,kinse nuk eshte I denuar e as ne hetime

ËSHTË PERGJEGJËS

Sepse me date 02.07.2012 eshte konstatuar se I njejt i me kohe nuk e deklaruar formularin mbi deklarimin e pasurise,nuk iu ka permbajtur nenit 9 t[Ligjit mbi Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarve public, si zyrtare I lart per deklarimin e pasurise,sepse si keshilltare e KK Gjilan,pas afatit ligjor nuk e permbush kete obligim Ligjor.

Me qka ka kryer veper kundervajtese nga neni 17.al.1.3,Per deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurise dhe te zyrtarve te larte Publik.,dhe per ate shpallet pergjegjes dhe

DENOHET

ME DENIM ME GJOBË ne Shumen prej 300 (Tre qind euro),te cilen gjobe I pandehuri eshte I obliguar ta paguaj ne afate prej 15 ditesh nga dita e plotefuqishmerise se ketij Aktvendimi ne te kunderten,gjoba do te zavendsohet ne denim burgu kun je dite burgu ka per tui llogaritur 20 euro.

Obligohet I pandehuri qe ne emer te paushallit gjyqësor të paguaj prej 5 euro,ne afatin e njejtë si dënimi me gjobë.

Arsyetim

Agjensioni kundër kurupsionit me kerkesen e vetë nr. 01-2363/12 te datës 18.07.2012 ka kerkuar qe kunder te pandehures te zhvillohet procedura dhe të ndeshkohet sipas Ligjit.

Gjykatësi i divizionit te kundervajtjes duke u bazuar ne Ligj,thirri te pandehuren i cili me date 23.12.2013 u deklarua ne lidhje me vepren kundervajtese e i cili ne deklaraten e vete nder të tjera ka theksuar:Se të dhënat në kërkesë janë të sakta,por se deri te kjo gjendje ka ardhur si pasoj e neglizhencës se Organit komunal te Gjilanit sepse te njëjt i nuk na kan njoftuar me kohe dhe se nuk na i kan ofruar Formullaret per deklarim të Pasurisë, e ndi veten fajtor dhe shprehi keqardhje per këtë lëshim

Pasi që pandehuri e ka pranuar ne tersi kundervajtjen e bërë,gjykatësi nuk pati nevojë të shtjelloj prova tjera,andej e shpalli përgjëgjës për vepren kundervajtëse dhe i shqipto nje denim sa ma të butë,si në

-2-

dispozitiv të këtij Aktvendimi dhe ate duke u bazuar ne nenin 17,p1, të Ligjit Per deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurise dhe te zyrtarve te larte Publik.

Me rastin e matjes së së dënimit me gjobë,gjykata me kujdesë vlersoi mbrojtjen e të pandehurit si dhe shkresat e lëndës duke u bazuar ne rethanat lehtësuese dhe renduese në lidhje me veprën kundërvajtëse në fjalë.**Andej duke e zbatuar nenin 9 të LMK-së Gjykatësi zbuti jashtezakonisht denim e parapar ligjor**,duke mar parasysh se ky është denim I pare dhe se ne të ardhmen është deklaruar se nuk do të kryej veper tjeter të llojit të njejt,është Jurist I pa punë,dhe se nuk do të përsrisë kundërvajtjen e tillë,kurse si rethan renduese u muar pesha e kundërvajtjes dhe I shqiptoi kete denim,I bindur se edhe me kete denim ka për tu arritë qëllimi I dënimit tek I pandehuri,Vendimi mbi paushallin gjyqësor u muar në bazë të nenit 109 par.1 të Ligjit mbi kundervajtjet,

Me sa u tha me lartë u vendosë sin ë dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DIV.KUNDËRVAJTJES
ME 23.12.2013**



Gjyqëtari
Veli KRVEZIU

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIKË :Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë ,Divizionit për kundërvajtje,ankesa dorëzohet perms këtoj Divizioni.